

**KONTRATË DHURIMI**  
**KUOTA të "J.K.B. CONSULTING" sh.p.k.**

Sot në Tiranë, më **06.10.2023**, lidhet kjo kontratë dhurimi midis palëve të mëposhtme:

**Dhuruesi:** znj. Jonida Begaj Gokov lindur në Vlorë në datën 05.09.1982 me nr. personal I25905184F, madhor me zotësi të plotë për të vepruar (në vijim Dhuruesi).

DHE

**Përfituesi:** Z. Elez Imeraj lindur në Vlorë në datën 20.07.1983 nr. personal I30720105R, madhor me zotësi të plotë për të vepruar (në vijim Përfituesi).

Palët në marrëveshje midis tyre, me vullnetin e tyre të lirë si dhe në përputhje me nenet 761 e në vijim të Kodit Civil, ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar e në veçanti neni 73 e vijues, nenin 15 të Statutit të shoqërisë J.K.B. Consulting shpk, bien dakord për lidhjen e kësaj kontrate si më poshtë vijon:

NENI 1

OBJEKTI I KONTRATËS

Objekti i kësaj kontrate është dhurimi i kuotës së kapitalit që korrespondon me 51% të vlerës së kapitalit shoqërisë **J.K.B Consulting sh.p.k.**, me NUIS **M12204009A** dhe Seli në adresën, Rruga Sulejman Delvina, P43, Sh28, Ap. 169, Tiranë, në pronësi të palës dhuruese znj. Jonida Begaj Gokov tek pala përfituese z. Elez Imeraj i cili pranon, nga pala dhuruese, dhurimin e 51% të vlerës së kapitalit shoqërisë.

NENI 2

QËLLIMI

Kjo kontratë ka për qëllim kalimin pa shpërblim të kuotës së kapitalit që korrespondon me 51% të vlerës së kapitalit shoqërisë J.K.B Consulting Shpk, me NUIS M12204009A, objekt i kësaj kontrate, tek Përfituesi.

NENI 3

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E DHURUESIT

1. Dhuruesi garanton Përfituesin për përkatësinë e sendit, objekt të kësaj kontrate, si dhe për mosçënimin e të drejtave të personave të tretë.
2. Dhuruesi garanton pranuesin e dhurimit se këto kuota janë të lira nga çdo barrë ose detyrim ndaj të tretëve dhe se për çdo pretendim që mund të ngrenë të tretë për çënimin e pronësisë së palës pranuesë të dhurimit, është i gatshëm të paraqitet me kërkesë të palës pranuese, para të gjithë organeve gjyqësore dhe administrative, për të mbrojtur të drejtat e përfituesit, si pronar i ligjshëm i kuotës së kapitalit, pas nënshkrimit të kësaj kontrate.



NENI 4  
PRANIMI I PËRFITUESIT

Përfituesi i sendit, objekt i kësaj kontrate, vendos të pranojë dhurimin me nënshkrimin e kësaj kontrate.

NENI 5  
DOKUMENTACIONI I DHURIMIT

Kësaj kontrate dhurimi do t'i bashkëlidhen fotokopjet e mjeteve të identifikimit të palëve me nënshkrimin e tyre përkatës nga të dyja palët.

NENI 6  
FORCA MADHORE

1. Dhuruesi nuk do të jetë përgjegjës dhe/ose ka të drejtë të zgjidhë kontratën në rastet e forcës madhore, të cilat përfshijnë, por pa u kufizuar në to, katastrofat natyrore, luftërat, kryengritjet dhe/ose çdo shkak tjetër jashtë kontrollit të arsyeshëm të Dhuruesit, që nuk përmbush detyrimet e tij për këtë arsye.

2. Në rast force madhore, Dhuruesi duhet të njoftojë menjëherë Përfituesin mbi natyrën e forcës madhore dhe kohëzgjatjen e mundshme të efekteve të saj.

NENI 7  
DISPOZITA TË FUNDIT

1. Kjo kontratë përfundon efektet e saj, me regjistrimin e kalimit të pronësisë së kuotës së kapitalit, objekt të kësaj kontrate, në emër të Përfituesit, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me përcaktimet e ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit".

2. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë kontratë, çdo palë do të përballojë shpenzimet e veta në lidhje me zbatimin e kësaj kontrate.

3. Kjo kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

4. Mosmarrëveshjet, që mund të lindin ndërmjet palëve, do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, që burojnë nga zbatimi i kësaj kontrate është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5. Kjo kontratë përmban 2 (dy) faqe dhe hartohet në gjuhën shqipe, në 3 (tre) kopje origjinale me të njejtën vlerë ligjore.

**Dhuruesi**

Z. Elez IMERAJ

ELEZ IMERAJ

**Përfituesi**

znj. Jonida BEGAJ GOKOV

Jonida Begaj Gokov